



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 34

Datë 21 mars 2014

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KZHR
nr. 1, datë 19.3.2014

Për shpalljen e afateve dhe të kriterëve për ndarjen e fondit për
infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve...

783

VENDIM
Nr. 1, datë 19.3.2014

**PËR SHPALLJEN E AFATEVE DHE TË
KRITEREVE PËR NDARJEN E FONDIT PËR
INFRASTRUKTURËN VENDORE, PJESË E
FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3 të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarja e fondeve për projekte të infrastrukturës vendore në vlerën prej 5 850 000 000 (pesë miliardë e tetëqind e pesëdhjetë milionë) lekësh, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, të bëhet në dy thirrje për aplikim, si më poshtë vijon:

a) Thirrja I, në vlerën prej 3 500 000 000 (tre miliardë e pesëqind milionë) lekësh, në mars - prill 2014, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Thirrja II, në vlerën prej 2 350 000 000 (dy miliardë e treqind e pesëdhjetë milionë) lekësh, në prill 2014.

2. Shpalljen e thirrjes për aplikime për projekte të infrastrukturës vendore, thirrja I, sipas vlerës së përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij vendimi, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014. Kjo thirrje për aplikim përfshin projekte të infrastrukturës vendore të lidhura me rivitalizimin dhe zhvillimin urban e rural, integrimin e zonave informale, si dhe projekte të vogla lokale, me ndikim, të infrastrukturës vendore.

3. Aplikimi për fonde të thirrjes I, për financimin e projekteve të infrastrukturës vendore, bëhet sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, nga njësitë e qeverisjes vendore (qarqet, bashkitë, komunat). Aplikimet për projektet dërgohen,

sipas formatit të dhënë në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Shqyrtimi për financim bëhet për projektet e aplikuara, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi. Procedura e vlerësimit kryhet pranë sekretariatit përkatës teknik, si dhe pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas kriterëve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Financave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	anëtar
Ministri i Financave	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar
Ministri i Shëndetësisë	anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar
Ministri i Kulturës	anëtar
Ministri i Mjedisit	anëtar
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar

SHTOJCË I
KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
19 mars 2014	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projektaplikime për projekte të infrastrukturës vendore (thirrja I e financimit)
19-31 mars 2014	Njësitë e qeverisjes vendore (qarqet, bashkitë, komunat)	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: Aplikimi <i>online</i> në faqen elektronike: www.dsd.gov.al . Aplikimi me shkresë zyrtare (postë), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, si edhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit) Shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit.
31 mars-10 prill 2014	Sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit)	Vlerësimi teknik e financiar i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III.
10 prill 2014	Sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, FSHZH)	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve me vlerësimin përkatës teknik dhe financiar.
10-5 prill 2014	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Vlerësimi strategjik i projekteve të aplikuara, sipas pikës B, shtojca III.
10-15 prill 2014	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Përgatit materialet për vendimmarrje për Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve.
15-20 prill 2014	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR)	Vendimmarrje në lidhje me projektet për t'u financuar, nga thirrja I e financimit për infrastrukturën vendore, si pjesë e FZHR-së.

Shënim**Procesi i vlerësimit**

Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza. Faza e parë përbën vlerësimin teknik dhe financiar të projekteve, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi teknik dhe financiar i projekteve, sipas kriterëve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit, kryhet nga sekretariati teknik për objektet e infrastrukturës vendore, i ngritur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Sekretariati teknik i paraqet zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, listën e plotë të projekteve me vlerësimin përkatës, të bërë sipas kriterëve të përcaktuara në pikën A të shtojcës III bashkëlidhur vendimit.

Faza e dytë e vlerësimit të projekteve bëhet sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I të këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve kryen vlerësimin përfundimtar të projekteve, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën B të shtojcës II bashkëlidhur vendimit.

SHTOJCË II
FORMATI I APLIKIMIT

Aplikuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues: qarkut, bashkisë, komunës, bordit të ujitjes dhe kullimit, universitetit apo ujësjellës sh.a.
Titulli i projektit (*)	
Lloji/ sektori i projektit (*)	Të përcaktohet cili është sektori ku bën pjesë projekti (infrastrukturë vendore).
Nësektori i projektit (*)	Cili është nësektori ku bën pjesë projekti.
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Data e aplikimit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të përshkruhet se ku konsiston projekti; cilat janë problemet që adreson; cila është vendndodhja e objektit të investimit, risqet për zbatimin e tij, ndikimi etj., sipas kriterëve mbi bazën e të cilave do të vlerësohet projekti.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqiten qëllimi dhe objektivat e projektit.
Numri i përfituesve (*)	Të paraqitet se sa është popullsia që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga projekti në total.
Përshkrimi i numrit të përfituesve (*)	Të përcaktohet sa është numri i përfituesve të drejtpërdrejtë dhe sa është numri i përfituesve të tërthortë, duke dhënë një shpjegim të shkurtër.

Rendi prioritar (*)	Paraqisni duke i vendosur një numër rendor, në rastet e aplikimit të më shumë se për një projekt në një fushë nga një njësi e qeverisjes vendore (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet dhe të analizohet nëse njësi vendore do të ketë nga ky projekt: kosto për mirëmbajtjen (nëse do ketë, sa parashikohen, si do të sigurohen etj.).
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga NJQV-të apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësi e qeverisjes vendore	
Financim nga donatorë	Nëse ka financim nga donatorë.
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi.
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një studim fizibiliteti të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/jo
Përmbledhje e studimit të fizibilitetit	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e studimit të fizibilitetit, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.
Statusi i aplikimit (*)	Të specifikohet nëse projekti është në aplikim (në rast se nuk është përfunduar ende aplikimi) ose nëse aplikimi është përfunduar.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim (*)	Të përshkruhet nëse projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe përfundojë zbatimi i punimeve.
Dokumentet e miratimit të projektit nga njësi e qeverisjes vendore (*)	Të përshkruhet statusi aktual i projektit, duke paraqitur nëse: - për projektin ka vendim për miratimin nga ana e këshillit të njësisë vendore (komunës/qarkut/bashkisë); - për projektin ka vendim të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore për miratimin e projektit; -projekti është përfshirë në listën e miratuar nga këshilli i njësisë vendore për financim (kur është parashikuar bashkëfinancimi); - projekti është miratuar nga këshilli përkatës i njësisë vendore vendndodhja e objektit. Për të gjitha rastet e sipërpërmendura, të cilësohen numri dhe data e miratimit të vendimit, si dhe të citohet dokumenti.
Përshtatja strategjike (*)	Të paraqitet dhe të specifikohet nëse projekti është: - pjesë e strategjisë vendore (të bashkisë apo komunës); - pjesë e strategjisë së zhvillimit të qarkut; - pjesë e planeve të investimeve kapitale të njësisë së qeverisjes vendore; - pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se ç'loj plani). Për të gjitha rastet e sipërpërmendura, të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo planit, si dhe të citohet dokumenti.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - projektin teknik, - preventivin, - argumentimin teknik, -përlllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit.

(*) Fushat që kanë *, janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

SHËNIM

Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

Aplikimet për projekte dërgohen në:

Aplikimi *online* në faqen elektronike: www.dsd.gov.al,

Aplikimi me shkresë zyrtare (postë), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, si edhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit).

2. Përveç aplikimit si më lart, institucionet aplikuese dërgojnë shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin e dërgimit të aplikimit pranë sekretariatit teknik dhe listën e projekteve të aplikuar, të renditura sipas prioritetit që i jepet nga aplikanti.

SHTOJCË III KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Pika A. Kriteret e vlerësimit teknik

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi maksimalisht me 70 pikë i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik për projektet e infrastrukturës vendore, i ngritur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet, që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë, si dhe ato projekte, ku kostimi i projektit dhe preventivi është përpiluar dhe vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve, etj., do të vlerësohen për financim, duke pasur një vlerësim me pikë nga 0 deri maksimalisht 25 pikë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si pjesë e sekretariatit teknik, ngarkohet të kryejë rishikimin financiar të kostimit dhe preventivave të projekteve me potencial, të paraqitura nga aplikantët, sipas buletineve të çmimeve, kostove referencë etj., si dhe të përgatisë raportin e vlerësimit financiar të tyre dhe rekomandimet përkatëse.

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me 0 deri maksimalisht 10 pikë.

3. Ndikimi i projektit që vlerësohet me maksimalisht 0 deri në 10 pikë, sipas komponentëve si më poshtë vijon:

- Në më shumë se një njësi vendore, bazuar në faktin, që projekti i investimit përfaqëson interesat e më shumë se dy njësi vendore. Kriteri inkurajon ato projekte që prekin më shumë se një njësi vendore, pasi

ndikojnë në një numër më të madh banorësh, si dhe në konsolidimin e strukturës ekonomike të zonave apo qarqeve të ndryshme. Për këtë komponent vlerësimi përfshin 0 deri 5 pikë.

- Në shërbimet bazë dhe cilësinë e jetesës. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në maksimalisht 5 pikë.

4. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore apo fondet e donatorëve. Ky kriter vlerësohet me 0 deri në maksimalisht 5 pikë.

5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të banorëve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë, duke pasur një vlerësim me pikë nga 0 deri maksimalisht 10 pikë.

6. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si: studimi i ndikimit në mjedis, analiza kosto-përfitim, studimi i fizibilitetit të projektit etj. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me 0 deri maksimalisht 5 pikë.

7. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me 0 deri maksimalisht 5 pikë.

Pika B. Kriteret e vlerësimit strategjik

Përdoren nga sekretariati i përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar në nivel vendor, qarku apo kombëtar, duke vlerësuar një projekt me maksimalisht 30 pikë, sipas kriterëve në vijim:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal/kombëtar dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonal/kombëtar. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.

2. Potenciali për zhvillim, qëndrueshmëria dhe për tërheqjen për investime të reja dhe/apo faza të reja të zhvillimit, që paraqet projekti. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 8 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006